



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sigurimi i jetës dhe i shëndetit të punonjësve të ERE”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
66512200-4; 66511000-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,000,000 lekë (dhjetë milion lekë) (përfshirë nga TVSH).

Përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit: është bërë në zbatim të nenit 78 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku ”Komisioni i Testimit të Tregut dhe i Përlllogaritjes së fondit limit”, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të ERE, ka marrë oferta nga 3 (tre) operatorë ekonomikë që veprojnë në treg në fushën objekt të procedurës së prokurimit, dhe nga mesatarja e vlerave të ofertave të paraqitura është përcaktuar vlera e fondit limit të kësaj procedure.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Enti Rregullator i Energjisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatorët ekonomikë, në zbatim të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” duhet të paraqesin Licencë “Për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit” (Veprimtaria e sigurimit të jojetës), Klasa 1 “Sigurimi i aksidentëve” dhe Klasa 2 “Sigurimi i sëmundjeve” si dhe (Veprimtaria e sigurimit të jetës) Klasa 19 ”Sigurim jete”, licensë e lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1 e LPP dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr.52, date 22.05.2014 ”Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit” . kriteri i vendosur për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale të operatorëve ekonomikë në lidhje ushtrimin e aktivitetit objekt procedure prokurimi, pasi vetëm kompanitë e licensuara mund të operojnë treg dhe të ofrojnë këtë shërbim konform legjislacionit në fuqi

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin Vërtetim nga Drejtoria Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025). Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën në një nga tre vitet e fundit financiar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet..

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, pika 3, e LPP , nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt të prokurimit si dhe për t’u njohur me gjendjen ekonomike të OE për tre vitet e fundit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 %, të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të deklaruara në organet tatimore.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikes 4/b të nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët

ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata shërbimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST dhe dispozitat e kontratës.

II. Argumentimi i Termave të Referencës

Termat e Referencës së procedurës së prokurimit janë hartuar nga struktura përkatëse në ERE, duke pasur parasysh numrin total të punonjësve dhe pozicionet e tyre, për të përfituar shërbimin e sigurimit të jetës dhe të shëndetit, të ndarë sipas niveleve të caktuara, për një periudhë 12 mujore.

Njësia e Prokurimit